

Rrjetezimi dhe Advokim per Aksione Komunitare te Ruajtjes se Burimeve Natyrore Lokale



Jahir Cahani

2

Financuar nga Komisioni Evropian



Ministria e Transportit, Energjitikës dhe Infrastruktura BKT



Qeveria e Republikës së Shqipërisë
Ministria e Transportit, Energjitikës dhe Infrastruktura BKT

Agjencia Ndërkombëtare për Shërbime dhe Transportim BKT





Permbajtja

Hyrje.....	2
1.Kushtet natyrore të zonës së Hasit.....	3
2.Burimet natyrore dhe përdorimi i tyre.....	3
3.Investigimi për përdorimin e pyjeve dhe gjuetinë.....	6
4.Investigimi për përdorimin e bimëve mjeksore.....	6
5.Investigimi në sektorin mineral.....	8
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	10
.....	Error! Bookmark not defined.





Hyrje

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Rrjetëzimi dhe Advokim për Aksione Komunitare të Ruajtjes së Burimeve Natyrore Lokale”, me mbështetjen financiare të LëvizAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë për ndërtimin e një qytetarie (lëvizje komunitare) aktive, partnere e njohur në procesin e qeverisjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm në nivel lokal dhe kombëtar. Për këtë synohet:

1. Të nxisë rrjetëzime kombëtare dhe lokale aktive të OShC-ve për ruajtjen e natyrës dhe partneritetin e tyre në programe pune afatgjatë advokimi për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

2. Të rrisë angazhimin qytetar/komunitar dhe mediatic në aktivitetet advokuese të OShC-ve për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore lokale, duke përdorur të drejtën për informacion dhe pjesëmarrje mbi procesin e zbatimit të politikave dhe vendimmarrjes që ndikon në burimet natyrore lokale.

Ky raport mbi vlerësimin e përdorimit të burimeve natyrore, promovimit të tyre dhe zbatimin në praktikë të legjislacionit të fushës së ruajtjes të natyrës ju vjen në ndihmë Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile (OMShC), të rajonit, institucioneve me varësi qendrore që veprojnë në nivel vendor si; Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdRZM), Drejtorisë Rajonale të Mbrojtjes Mjedisit, përfaqësuesve të Bashkisë, Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, në lidhje me investigimin e legjislacionit ekzistues për ruajtjen e natyrës, për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të tyre në praktikë.

Raporti u përgatit nga organazita Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimit të Turizmit (MMZHT), si pjesë e veprimtarisë së këtij institucioni, në kuadër të “Rrjetëzimi dhe Advokim për Aksione Komunitare të Ruajtjes së Burimeve Natyrore Lokale”, me ekspertë të fushës dhe me ndihmën e sugjerimet e partnerëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile në nivel lokal, me të cilët është bashkëpunuar për realizimin e projektit.

Platforma e investigimit është në harmoni dhe në vijueshmëri me analizën dhe monitorimin e kryer për legjislacionin për ruajtjen e natyrës në Shqipëri.

“Ky botim u realizua nga projekti “Rrjetëzimi dhe Advokim për Aksione Komunitare të Ruajtjes së Burimeve Natyrore Lokale”, me mbështetjen financiare të LëvizAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit”.

Riprodhimi i këtij botimi për qëllime edukative ose qëllime të tjera jo tregtimi, nuk është i autorizuar pa miratimin paraprak me shkrim nga mbajtësi i autorësisë, duke mirënjohur plotësisht burimin.





1. Kushtet natyrore të zonës së Hasit

Zona e hasit ndodhet në pjesën verilindore të Shqipërisë dhe është nën ndikimin e klimës mesdhetare paramalore. Klima karakterizohet nga një verë e nxehtë dhe e thatë e me dimër të ftohtë, të ashpër. Sasia më e madhe reshjeve bie në pranverë dhe në vjeshtë e vonë. Reshjet janë në formën e shiut dhe të borës. Reshjet e borës bien në sasi më të mëdha në fund të dhjetorit e deri në shkurt. Lartësia e borës në disa raste kalon mbi 1.5m në zonën e Cahanit dhe Pashtrikut. Sasia mesatare vjetore e reshjeve lëkundet nga 900 – 1000 mm ne vit. Temperatura mesatare vjetore është 11,4 °C. Mesatarja e janarit është (0-1 °C) dhe e korrikut (23 - 24 °C). Minimumi absolut ka qene (-21 °C) ne janar 1985 dhe maksimumi absolute (41 °C) ne korrik 2004

Relievi është kodrinor-malor me ndryshueshmëri të madhe me lartësi mesatare 400-500m mbi nivelin e detit. Pika më e lartë e relievit është maja e malit të Pashtrikut 1989 m. ndryshueshmëria e relievit vjen edhe për shkak të ndërtimit të ndërlikuar gjeologjik të zonës. Këtu janë mjaft të shfaqura fenomenet e karstit në formën e gropave të mëdha e të vogla veçanërisht në zonën e Pashtrikut dhe Cahanit duke krijuar një pejsazh tejet të veçantë.

Zona e hasit është e varfër në burime hidrike nëntokësore e sipërfaqësore. Burimi më i madh sipërfaqësor është lumi i Krumës i cili ushqehet nga përroi i Rusmanit, Vlahnës, i Vranishtit, i Leshnicës dhe Skatinës. Prurjet e këtyre degëve në periudhën e verës janë në kufij minimal deri në shterrim të plotë. Për të pasur një bilanc hidrik të pranueshëm për bujqësinë në periudhën e verës janë ndërtuar disa rezervuare.

2. Burimet natyrore dhe përdorimi i tyre

Hasi sipas ndarjes së re territoriale është i organizuar në një bashki të vetme, Bashkia e Hasit me qendër qytetin e Krumës. Bashkia e Hasit ka një pupullsi prej 22,200 banorë dhe një sipërfaqe prej 374 km².

Bashkia Has ne veri dhe në lindje kufizohet me kufirin shtetëror të Kosovës. Në jug dhe në perëndim kufizohet me Bashkinë Kukës me të cilën e ndan Drini i Bardhë dhe i bashkuar, sot liqeni i Fierzës, ndërsa në veri-perëndim përroi i Skatinës e ndan nga bashkia Tropojë.

Bashkia e Hasit ndodhet në verilindje të Shqipërisë dhe bën pjesë në Qarkun e Kukësit.

Zona e Hasit përfaqëson një pjesë nga thesari i pasurisë dhe bukurisë natyrore të vendit tonë. Zona është tipike malore dhe që karakterizohet nga një reliev i ndryshueshëm, pejsazhe të larmishme që afrojnë pamje të mrekullueshme, biodiversitet të pasur, pyje, kullota, monumente të natyrës, shpella dhe bimë e kafshëtë e rralla. Shfrytëzimi i burimeve natyrore, pyjeve, thjeshtë për nevoja





ekonomike, pa marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi dhe parimin për zhvillimin e qëndrueshëm, ka çuar në disa raste në dëmtime të konsiderueshme, veçanërisht për habitatet pyjore dhe bimët mjekësore, në pakësim e zhdukje të potencialeve biologjike dhe të faunës së egër.

Kuadri ligjor në fushën e mbrojtjes së natyrës lë për të dëshiruar në aspektin e zbatimit të tij në praktikë. Qëndrimi dhe sjellja e qeverisjes vendore ndaj mjedisit në përgjithësi dhe natyrës në veçanti ka qenë dhe vazhdon të jetë e ngathët e pasive. Edhe vete komuniteti dhe shoqëria civile lokale nuk ka kapacitetet e duhura për të qenë pjesmarrës aktiv në procesin e identifikimit të problemeve prioritare dhe propozimin e masave përkatëse. Mungesa e përvojës, edukimit mjedisor e sidomos mungesa e kapacitetve lokale i thellojnë më shumë problemet me të cilat po përballet natyra dhe ekosistemet më me vlerë në këtë zonë

Per të mbrojtur dhe për të ruajtur burimet dhe vlerat natyrore të kësaj zone nga aktivitetet e pakontrolluara dhe ilegale nga dëmtimi i mëtejshëm, është e nevojshme ndërmarrja e iniciativave të përbashkëta nga komuniteti dhe autoritetet e qeverisjes vendore, përmes edukimit dhe ndërveprimeve konkrete me qëllim përmirësimin e cilësisë së ekosistemit natyrore dhe shërbimet e tij.

Kushtet natyrore formacioni gjeologjik dhe pozita e kësaj zone si urë lidhëse ndërmet alpeve dhe vargmalit Korab Koritnik ka ndikuar në praninë e burimeve natyrore të larmishme. Siç janë sipërfaqe të mëdha me pyje dushku, ahu, kullota malore dhe alpine, habitatet e të cilave janë strehë për një shumëllojshmëri bimësh mjeksore e të rralla, dhe "shtëpia" e llojeve të rëndësishme shtazore. Nëntoka e zonës është pasur në minerale si krom, hekur nikel etj. Këto burime natyrore janë përdorur historikisht nga banorët për të siguruar të ardhura dhe mirëqenien e tyre. Disa objekte per vlerat e venta të tyre janë pjesë e rrjetit të zonave të mbrojtura, "Tejdrinit bardhë" rezervat I menaxhuar, monumentete e natyrës si ahishta e Liqenit të Kuq, pisha e Gjinajve, shpella e Dajcit, Shpella e Pellumbave, Maja qytezës. Gjithashtu është në fazën përfundimtare studimi i përbashkët me palën kosovare për shpalljen park natyror ndërkuftar të zonës së malit të Pashtrikut e Drinit të Bardhë.

Në përdorimin e burimeve natyrore shpesh herë ka pasur e ka probleme në respektimin e zbatimit të ligjit në praktikë. Për identifikimin e problemeve në kudër të projektit u organizuan disa takime me aktorë të ndryshëm si dhe u bënë investigime, në fushat që u konsideruan më problematike.



Foto





ANALIZA E TË DHËNAVE TË PYETËSORIT DHE PËRGATITJA E RAPORTIT

I. Investigimi për përdorimin e pyjeve dhe gjuetinë

Zona e hasit është zonë përqindjen më të madhe të fondit pyjor ka me pyje dushku. Politikat e ndjekura ndër vite nuk kanë qenë favorizuese për këtë sektor. Kështu në vitet (60-70) u bë shpyllëzimi i plotë 5500 ha për ti kthyer në tokë buke dhe kullota. Kjo ndikoi negativisht ju vetëm në humbjen e fondit pyjor por edhe ndryshim rrënjësor të habitatit që solli pasoja të rënda edhe në humbjen dhe pakësimin e shumë llojeve shtazore që lidheshin me këtë habitat. Sipërfaqe të konsiderueshme u degraduan nga shfrytëzimi për industrinë e drurit dhe dru zjarri. Mbas viteve 90 vazhdoi shfrytëzimi tyre pa kriter, duke pakësuar edhe më shumë fondin pyjor. Në zonën e Hasit e gjithë popullsia përdor drurin si lëndë djegëse për ngrohje. Dhjetëvjeçarin e fundit drutë për zjarr përdoren vetëm në stinën e dimrit, ndryshe nga vite përpara që përdorëshin gjatë gjithë vitit edhe për gatim. Sasia që përdoret nga familjet është e madhe. Nga intervistimet del se 60% e familjeve konsumojnë 10-12m³ dru kryesisht dushku. Me shpalljen e moratoriumit prerjet ilegale janë ulur ndjeshëm megjithatë ende ka raste. Sipas bisedave me komunitetin lënia e ndëshkimit të barabartë për të gjithë kundravajtësit nuk është e përshtatshme dhe efekti nuk ka qenë ai që pritej. Gjatë investigimeve konstatohet se në disa raste mungojnë planet e menaxhimit në raste të tjera janë të vjetëruara gjë që sjell mjaft pengesa për për specialistët e zrës pyjeve pranë bashkisë. Përdorimi i drurit bëhet sepse nuk ka alternativë tjetër dhe është ende më i lirë.

Moratoriumi për gjuetinë ka ndikuar mjaft pozitivisht. Kjo vihet re në shtimin e gjitarëve të mëdhenj si lepuri, dhelpra, ujku, macja e gër vjedulla, dhe shtimin e llojeve të shpendëve objekt gjuetie si turtulli, thëllënxa e malit dhe thëllënxa e fushës. Megjithatë gjatë investigimeve janë konstatuar disa raste të gjuetisë së paligjshme raste të cilat nuk janë konstatuar dhe nuk janë ndëshkuara ng institucionet përgjegjëse. Sot në bashkinë e Hasit ka 296 armë gjahu, të dhëna me leje, nga të cilat vetëm 70 prej tyre janë në përdorim të gjuetarë të cilët janë anëtarë të shoqatës së gjuetarëve dhe paguajnë të gjithë detyrimet, duke iu nënshtruar ligjeve dhe rregullave në fuqi. Roli i institucioneve ligjzbatuese për moratoriumin duhet të forcohet, për ndalimin e plotë të gjuetisë së paligjshme.

II. Investigimi për përdorimin e bimëve mjeksore.

Në zonën e hasit nga popullsia njihen mirë disa lloje bimësh mjeksore e fruta pylli, por pavarësisht kësaj vetëm disa prej tyre që kanë treg të garantuar, si sherbelja, njëmijëfletëshi, agulicja, trëndafili i egër, manaferra, molla e gër dhe lulballasami. Ky grumbullim është spontan dhe i pa organizuar. Grumbullimi bëhet në formën e organizimit familjar. Nuk ka pika grumbullimi dhe nuk ka biznese të licensuara vendase që merren me këtë veprimtari. Banorët produktin e grumbulluar e dërgojnë në subjektet e licensuara në kukës. Nga investigimet në terren rezulton se agulicja është e kërcënuar për shkak të shkuljes me rrënjë.

Nga intervistimet e bëra me banorë të ndryshëm nëse ata e njohin ligjin për bimët mjeksore përgjigja ka qenë e dimë që ekziston një ligj por vetëm kaq. Nga ana e sektorit të pyjeve në bashki ka probleme në zbatimin e këtij ligji.



Foto



III. Investigimi në sektorin minerar.

Zona e hasit është pasur në mineral kromi, bakri dhe hekur nikel, gurë gëlqeror. Nxjerrja dhe perpunimi i mineraleve deri në fillim të viteve 90 ky ishte shtetëror. Në 93 kjo indusri u mbyll duke lënë pasoja në mjedis, sasi të mëdha mbetjesh inerte, sipërfaqe të pa rehabilitura, galeri të pa mbyllura. Më të njohura ishin minieëra e kromit në Vlahën, Perollaj, miniera e bakrit dhe fabrika e pasurimit të bakrit në Golaj. Aktualisht për nxjerrjen e këtyre mineraleve ushtrojnë veprimtari disa subjekte private. Kjo veprimtari është me impact në mjedis, veçanërisht kur shfrytëzimi bëhet në karrierë. Vbeprimtaria e tyre është e shtrirë në disa zona si Vlahën, Gjinaj, Domaj, Perollaj, Gajrep Gzhime, Maç, Zgjec etj

Tabela e subjekteve qe ushtrojne aktivitete minerar.¹

Nr	Subjekti	Lloji i aktiviteti	Vendodhja
1	"Fabrika e pasurimit te Cr"shpk	Fabrike pasurimi Kromi	Perolla, Has
2	Info metal Plast sh.p.k	Shfrytezim kromi nentoke	Vlahen, Krume
3	BLERIMI KOSTURR 2010	Shfrytezim Kromi	Maç, Helshan, zgjec
4	VËLLAZËRIA sh.p.k	Nxjerrje kromi nga nentoka	
5	AFRIMI K sh.p.k	Shfrytezim Nikel-Silikati	Cahan, Krume, Has,
6	Ema chrom 2011 (LC 0357)	Shfrytezim NI-SI	Vllahen,
7	2R	Shfrytezim guri gelqeror	Krume
8	2R	Linje fraksionimi asf- betoni	Krume
9	Metal Resources Company	Kerkim-zbulim Fe-Ni	
10	Blerim-Kostur 2010	Kerkim, zbulim bakri	Zylfaj
11	Thaci Energji	HEC	Domaj
12	Cahani	Minere kromi	Vlahne
13	FATLUMI	HEC	
14	Kastrioti Minerals	Nxjerrja e mineralit dhe argjiles nga minjera ne qielle te hapur dhe nga guroret	Gjinaj
15	Neza 2004	Industria minerare ID 3.6 Minjerat nentoksore dhe veprimtarit e lidhura me to	Golaj
16	ELIDONI 06	Nxjerrja e mineralit dhe argjiles nga minjera ne qielle te hapur dhe nga guroret	Krume
17	EMMA Crom 2011	Minierat nentokesore dhe veprimtarite te lidhura me to	Krume

Probleme të konstatuara gjatë investigimeve në terren janë: mos zbatimi i kushteve të lejes mjedisore, mos zbatim i planeve të rehabilitimit.

Disa prej shkelejeve të kushteve të lejes mjedisore të vërejtura janë: mos kryerja e vetmonitorimit sipas periudhave të përcaktuara në lejen mjedisore, depozitimi i mbetjeve jashtë zonës së përcaktuar, emetimi i pluhurave dhe gazrave tej limiteve të përcaktuara, në lejen mjedisore, për shkak të mos përdorimit të teknologjisë së parashikuar në projektin teknik, mungesa e drenimit të ujrave të shiut.

¹ Të dhënat e tabelës janë marrë në DRM Kukës

Foto





Gjate analizimit të pyetesoreve të bëra në të gjithë territorin e bashkisë Has për katesishte në njesine administrative Golaj, Fajza, Gjinaj dhe Bashkinë Krume, janë plotësuar mbi 100 pyetesor, për problemet mjedisore në nivel lokal

Nga lista e problematikave të identifikuar nga plotësimi i pyetesoreve 2 problematika më prioritare në mjedis dhe burimet natyrore të cilat duhen bërë prezent në strukturat e bashkisë Has janë:

1. **Ndotja e mjedisit**
2. **Minierat, Guroret, Gërrmimet, Prodhimi i inerteve dhe marrja e zhavorit**

Njekohesisht po rëndisim edhe disa problematika të tjera mjedisore në nivel loka

Shfrytëzimi i tokës

- Humbja e tokës me cilësi të lartë bujqësore në zonën fushore e kodrinore;
- Zgjerimi i vendbanimeve dhe zonave tregtare e industriale;
- Toka të degraduara që e zvogëlojnë vlerën e peizazhit rural;
- Parcela të fragmentuara të tokave bujqësore;
- Coptimi dhe ndërrimi i destinacionit të tokave bujqësore.

Burimet ujore dhe menaxhimi i tyre

- **Menaxhim jo i duhur i ujërave të zeza;**
- Mungesa e trajtimit të ujërave urbane e rurale;
- Degradimi i shtretërve të lumenjëve;
- **Shfrytëzimi i pakontrolluar i burimeve ujore;**
- Cilësi dhe sasi e pamjaftueshme e ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor;
- Qasja në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit është ende e kufizuar për shumë fshatra;
- Mbrojtja jo efiçente e burimeve ujore.

Menaxhimi i mbeturinave

- **Menaxhim jo efiçent i mbeturinave dhe roli i njësive administrative;**
- Përfshirje jo e plotë e ekonomive familjare dhe e bizneseve në sistemin e grumbullimit të mbeturinave;
- **Numri i madh i deponive ilegale;**
- Ndarjes dhe reciklimit të mbeturinave, nuk behet fare.

Natyra dhe biodiversiteti

- Mbrojtje jo e mjaftueshme e biodiversitetit dhe e peizazhit natyror;
- Rritja e funksionalitetit, të përgjegjësisë të organeve menaxhuese, monitoruese dhe ligjzbatuese për zonat e mbrojtura, në nivel qendror e lokal;
- Mungesa e Planit lokal për mbrojtjen e biodiversitetit dhe zbatim jo i plotë i planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura;
- **Degradimi i pyjeve, prerjet ilegale në rritje dhe zjarret;**
- Mbi shfrytëzimi i llojeve të florës dhe faunës së egër përfshi peshkimin dhe kullotjen;





- Ndryshimi fizik i habitateve (shndërrimi, thjeshtimi dhe coptimi i tyre);
- **Mungese e planeve lokale për zhvillimin e turizmit dhe promovimit të ekoturizmit.**

Lista e prioriteteve është baza e punës dhe e veprimeve advokuese e lobuese, pranë organeve përgjegjëse në nivel qendror e vendor, nga OShC-t dhe OJF-t e rrjetëzuara.

Raporti dhe rezultatet e pyetësorit do të paraqitet bashkë me Has, duke adresuar problematikat, por edhe duke ofruar ndihmën dhe ekspertizën e organizatave të grupimit në ndërgjegjësimin e publikut dhe aktorëve të tjerë si dhe në zgjidhjen e problemeve lokale.

KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

Në kuadër të zbatimit të projektit “Rrjetëzimi dhe Advokim për Aksione Komunitare të Ruajtjes së Burimeve Natyrore Lokale”, me mbështetjen financiare të LëvizAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Gjatë takimeve të organizuara nga MMZHT, me disa përfaqësues të OShC, AdRZM ISHMP-se dhe me përfaqësues nga strukturat përgjegjëse për mjedisin dhe natyrën, në Bashk si dhe rrjetin Mbrojtja e Natyrës Hasi; në lidhje me zbatimin e programit të trajnimit për përforcimin e kapaciteteve në investigimin legjislativ ekzistues për ruajtjen e natyrës, për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të tyre në praktikë, sipas pyetesoreve të realizuar rezultoi:

- a) legjislativi për mjedisin dhe mbrojtjen e natyrës nga punonjësit e bashkisë nga OShC-të dhe punonjësit e institucioneve përgjegjëse shtetërore është në nivele të ulëta. Kjo bën që zbatimi në praktikë i tyre është me mangësi të mëdha. Gjendja paraqitet më e rëndë në mosnjohjen e dispozitave ligjore dhe të akteve nënligjore për: Ligji nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar; Ligji nr.9867, datë 31.01.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar; Ligji nr. 5/2016, datë 04.02.2016 “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar; Ligji nr.10 120, datë 23.04.2009 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”, të ndryshuar dhe Ligji nr. 9867, datë 31.01.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për tregtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe të florës së egër”, të ndryshuar.
- b) Niveli arsimor i punonjësve të institucioneve ligjzbatuese në fushën e mjedisit lë mjaft për të dëshiruar. Zbatimi i ligjeve kërkon kualifikim dhe profesionalizëm të lartë ndaj ngana ana MM dhe institucioneve të varësisë duhet të organizohen takime trajnuese në vazhdimësi për rritjen e kapaciteteve të punonjësve.
- c) Vërehet mungesë e plotë e nismave promovuese për legjislativin mjedisor dhe të mbrojtjes së natyrës.
- d) Mungon pothuajse fare organizimi i fushatave ndërgjegjësuere e sensibilizuese si nga institucionet përkatëse ligjzbatuese ashtu edhe nga OSHC-të, për njohjen e vlerave natyrore të zonës dhe ruajtjen e tyre.





- e) Ndryshimet e shpeshta të punonjësve krijojnë të administratës së institucioneve ligjzbatuese dhe atyre të bashkisë janë një problem mjaft pengues në njohjen dhe zbatimin praktik të legjislationit.
- f) Vërehen tendenca për shmangien e përgjegjësive me pretendimin mos pasjes së kompetencave dhe lënien e “fajit” tek të tjerët.
- g) Bashkëpunimi ndërinstitucional nuk është në nivele të kënaqshme e në disa raste mungon fare gjë që krijon hapsira për mos zbatim të ligjeve në praktikë.
 1. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet institucioneve ligjzbatuese në fuashën e mjedisit, stafit të bashkisë dhe OMSC-ve është një domosdoshmëri për zbatimin praktik të ligjeve.
 2. MM, AKZM, dhe institucionet e tjera ligjzbatuese në fushën e mjedisit duhet te punojnë më shumë për njohjen e publikut me detyrimet që rrjedhin nga “Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit”, miratuar me VKM nr. 31, datë 20.01.2016 dhe zbatimin e tij në praktikë.
 3. Të organizohet në mënyrë profesionale brenda vitit 2018 procesi i inventarizimit, rregjistrimit dhe matrikullimit, dhe krjimit të sistemit të identifikimit, gjurmimit, zbulimit, trajtimit dhe parandalimit të zotërimit, mbajtjes në robëri dhe tregtimit të individëve të llojeve të faunës së egër.
 4. Strukturat e MM dhe të Bashkive, të ngrakuara me ligj, duhet të hartojnë planet e mbarështimit dhe të inventarizimit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore, dhe mbi bazen e tyre të caktohet sasia, lloji dhe koha e grumbullimi dhe vjeljes së tyre.
 5. Bashkia has duhet të jetë më aktive e të përfshihet në procesin e diskutimeve gjatë hartimit të ligjeve, udhëzimeve administrative dhe strategjive me qëllim dhënien e sugjerimeve për përmirësimin këtyre akteve ligjore, gjë që do të garantojë zbatim më të mirë të ligjit në terren.
 6. Në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore Rajonale, në orët e lira të programuara në kurrikulën shkollore të organizohen orë të hapura për njohjen e nxënësve me vlerat natyrore të zonës.
 7. MM dhe AKZM duhet të organizojnë seminare, me AdRZM dhe Bashkitë, për përgatitjen profesionale të stafeve përkatës të menaxhimit të zonave të mbrojtura, për të hartuar planet e veprimit për mbrojtje të natyrës, të biodiversitetit, të individëve të faunës së egër, si dhe menaxhimin e grumbullimit e bimëve mjekësore dhe aromatike, etj.
 8. Organizime periodike i takimeve të institucioneve ligjzbatuese në fushën e mjedisit dhe stafet e bashkive organizatat e shoqërisë civile që merren me çështjet e mjedisit dhe mbrojtjen e natyrës aktorët e përdorimit të burimeve natyrore me qëllim këmbimin e informacionit dhe eksperiencave më të mira me qëllim zbatimin praktik të tyre.
 9. Organizimi i fushatave promovuese e sensibilizuese në mediat locale si dhe prodhimi e shpërndarja e fletë palosjeve guidave CD për njohjen e vlerave natyrore dhe ruajtjen e tyre.
 10. Me stafet e bashkive të AdZM -ve, përfaqësues të shoqërisë civile duhet të organizohen seminare për njohjen e legjislationit mjedisore zbatimin praktik dhe paisjen me kuadrin e plotë legjislativ me qëllim rritjen e profesionalizmit.





11. AdZM, DRM, ISHMP nëpërmjet stafeve të tyre të organizojnë takime periodike me përfaqësues të komunitetit, Organizatave të shoqërisë civile nxënësit e shkollave për promovimin e vlerave natyrore të zonës dhe promovimin e legjislacionit mjedisor.
12. Ndryshimi i mënyrës së kontrollit dhe monitorimit nga stafet e DRM, ISHMP, AdZM dhe stafit të bashkisë që merret me mjedisin i veprimtarive që përdorin burimet natyrore.
13. Të sigurohet infrastruktura e nevojshme informues dhe pritëse në hyrje të të gjitha zonave që janë nën mbrojtje institucionale, me informacionet që ato zona duhen ruajtur dhe kërkojnë përkujdesjen e secilit.

